



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 05.09.2016

Ref.: 800/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht 2016, mori:

### V E N D I M

I. Riakreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji “Universum” për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2021:

- Biznes dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS, (me specializime: Menaxhment; Banka dhe Financa; Biznes Ndërkombëtar; Marketing dhe Komunikim), (maksimum 400 student për vit akademik), Prishtinë, Ferizaj, dhe Gjakovë;
- Menaxhment, MA, 120 ECTS, (me specializime: Menaxhment; Biznes Ndërkombëtar; Financa; Menaxhimi i Turizmit; Menaxhimi i Sektorit Publik), (maksimum 100 student për vit akademik)

II. Riakreditohen programet e studimit për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Shkenca Politike, BA, 180 ECTS, (me specializime: Administratë Publike; Marrëdhënie Ndërkombëtare; Studime Evropiane), (maksimum 200 student për vit akademik)
- Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS, (maksimum 260 student për vit akademik)

III. Akreditohet programi i studimit për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Anglisht, BA, 180 ECTS, (me specializime: Anglishte për Biznes dhe Media; Përkthim; Anglisht me Gjuhë Gjermane), (maksimum 60 student për vit akademik).

IV. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejnjë nga viti akademik 2017/2018.

V. Obligohet BPrAL Kolegji “Universum” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

VI. Obligohet BPrAL Kolegji “Universum” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji “Universum” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim dhe akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Biznes dhe Menaxhment	BA	180	Ejup Fejza, Selajdin Abduli, Florentina Halimi
2	Menaxhment	MA	120	Halil Bajrami, Nexhat Alija, Naser Miftari
3	Shkenca Politike	BA	180	Bekim Podrimqaku, Memet Memti, Lush Culaj
4	Shkenca Kompjuterike	BSc	180	Avni Pllana, Ervin Ramollari, Arbana Kadriu
5	Anglisht	BA	180	Lulzime Kamberi, Berikena Xhaferi, Bekim Nuhiu

AKA ka organizuar vizitë në BPrAL Kolegji “Universum” më 16.08.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Karmen Pizorn; Prof. Dr. Frederic Mertens de Wilmars; Prof. Dr. Kriistina Tonnisson; Prof. Dr. Peeter Normak.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25 Gusht 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji “Universum”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolejji “Universum”
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë